

Figura e Presidentit Woodrow Wilson në Historiografinë Shqiptare  
TEMA PËR TITULLIN MASTER TË HISTORISË

NGA

VALENTIN SELMANAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË

QERSHOR, 2024

**REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER**

**Mentori:** *Prof. Acos. Dr. Nuri Bexheti*

**Kandidati:** *Valentin Selmanaj*

**Tema:** *Figura e Presidentit Woodrow Wilson në Historiografinë Shqiptare*

Synimi i këtij punimi për nivelin e studimeve Master është të trajtojë temën “Figura e Presidentit Woodrow Wilson në Historiografinë Shqiptare”, e cila është një analizë gjithëpërfshirëse e mënyrave se si kjo figurë politike vizionare është portretizuar dhe vlerësuar nga historianët shqiptarë me kalimin e kohës.

Woodrow Wilson një ndër burrshtetasit më të mëdhenjë botërorë të shek. XX fitoi zgjedhjet presidenciale pak para se Shqipëria të shpallte Pavarësinë në nëntor të vitit 1912 dhe ishte përkrahës i palëkundër i çështjes shqiptare. Refuzimi që i bëri planeve për ndarjen e Shqipërisë i'a siguroi atij një vend shumë të rëndësishëm në historinë shqiptare.

Vizioni i Presidentit Wilson për botën dhe poashtu roli i shqiptaro-amerikanëve në rrethanat historike kontribuan në vendimin që do të rikonfirmonte pavarësinë e Shqipërisë.

Politikat e Wilsonit për vetëvendosjen e popujve ishin themelore në vizionin e tij për paqen dhe stabilitetin në planin ndërkombëtar. Ai promovonte të drejtën e popujve për të vendosur fatin e tyre dhe për të formuar shtetet e tyre të pavarura. Wilsoni kishte një qasje të qartë për të mbështetur pavarësinë e vendeve të reja, duke iu referuar principeve të vetëvendosjes dhe demokracisë. Ai shprehu këto ide në të 14-të pikat e tij, ku theksoi nevojën për një botë të bazuar në lirinë dhe drejtësinë. Politikat e tij për vetëvendosjen e popujve u bënë thelbësore në krijimin e shteteve të reja, përfshirë edhe Shqipërinë.

Kjo temë ka për synim po ashtu të ofrojë një pasqyrë lidhur me politikën amerikane ndaj çështjes shqiptare e cila është e një rëndësie vendimtare për historinë bashkëkohore të kombit shqiptar, ku shqyrtohen një sërë ngjarjesh më me peshë në historinë tonë, si:

Politika e jashtme Amerikane,

Konferenca e Paqes në Paris, e cila për nga rëndësia e vendimeve të saja dhe dimensionit i reflektimit të tyre zë një vend të posaçëm në rrjedhat e mëtejshme evropiane dhe historisë së popullit shqiptar, dhe më e rëndësishmja marrëdhëniet ndërmjet SHBA dhe kombit shqiptar të cilat fillojnë me një ndër burrshtetasit më të mëdhenjë botërorë të shekullit XX, Presidentin Woodrow Wilson i cili ishte kryetar shteti i një Fuqie të Madhe me peshë botërore në rritje, ai luajti një rol të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës.

Woodrow Wilson drejtoi Shtëpinë e Bardhë në vitet 1913-1921. Atëherë Evropa dhe mbarë bota u tronditën nga Lufta I Botërore (1914-1918), pasi që e pasoi dëshira e popujve për vendosjen e një paqje sa më të qëndrueshme.

Në këtë temë rëndësi tjetër i është kushtuar politikës Wilsoniane kundrejt çështjeve dhe konferencave me ndikim botëror deri tek njohja e Qeverisë së Shqipërisë nga SHBA. Njohja e Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara ishte një rezultat i përpjekjeve të Woodrow Wilsonit për të promovuar vetëvendosjen e popujve dhe pavarësinë e shteteve të reja. Kjo njohje ishte një hap i rëndësishëm për t'i siguruar Shqipërisë një vend në skenën ndërkombëtare.